

Subjekti ILIRJAN SUBASHI SHPK


VENDNDODHJA: MARIKAJ, VORE

NIPTI: K6220010S

AKTIVITETI: LINJE PERPUNIMI VAJI ULLIRI KODI 7.7 D)

7.7.d. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e produkteve ushqimore nga lëndët e para vegjetale

Vendndodhja e aktivitetit:



X: 4685274.504

Y: 4583033.446

Ilijan Subashi ka aktivitet te gjere ne procesin e perpunimit te ullirit per prodhimin e vajit sipas kerkesave te tregut. Aktiviteti i perpunimit te ullirit ushtrohet ne mjedise te reja dhe te projektuara e ndertuara sipas standarteve bashkekohore te kesaj fushe.

PROCESI TEKNOLOGJIK

- Peshimi i ullinjve
- Pastrimi i ullinjve
- Bluarje e ullinjve
- Trajtimi
- Procesi i "ekstraktimit" i mases se bluar me uje te vaket (-27 °C) te vajit te ullirit nga masa e bluar me dekantues/centrifuge -vecimi, depozitimi dhe largimi i bersise se ekstraktuar
- Eliminimi i ujrave (me separator) dhe perftimi vajit te ullirit,

Procesi i largimit te papastertive dhe i larjes.



Depozitimi i bersise se dale nga procesi



Magazini i bersive per tharje.

RISITË TEKNOLOGJIKE

Kjo teknologji posedon meritat e përpunimit pa shtuar uje (dy faza) plus shpejtesine e një nxjerrësi centrifugal që përshtatet shumë për përpunim të vazhdueshëm dhe për kohet e punës.

Lejon të përgatiten, direkt nga brenda ne kazan, një pjesë e salses qe quhet "pâté", e përbërë nga pulpë e nga lagështia e ullirit pa gjurmët e papastertive. Ky fraksion, përshtatet për përdorime të ndryshme (të tilla si përmirësues i tokës; si shtesa për mbarështimin e kafshëve; të përzier me biomasa të tjera për prodhimin e biogazit; si një përbërës i mundshëm për ushqime per njerëzit), ajo nuk është më një mbetje për tu asgjësuar, por një vlerë e shtuar per impiantin.

KARAKTERISITIKAT TEKNIKE

Ndryshueshmëria e rrotullimit të centrifugave. Është e mundur duke ndryshuar xhirot, pra shpejtesine e perpunimit te mases se pulpes, qe koha e qëndrimit të salses përgjatë kanaleve të konit rrjedhimisht lagështia e mbetur në të njëjtën pjese te jete e ndryshme. Pajisja për zbrazjen e kazanit garanton lirimin e të gjithë vajit të tij qe ka nxjerre. Pajisja e zbrazjes se kazanit lejon te kulloje plotësisht vajin nga kazani në çdo ndryshim të ngarkesave te ullirit. Disponohet në të gjitha modelet.

Amortizatore Inovative

ka një sistem të ri të amortizatoreve, të cilat eliminojne të gjitha llojete dridhjeve gjatë funksionimin e makinës.

Nr	Emertimi i treguesve	Nj.matjes	Sasia
A. Permasat e objektit			
1.	Siperfaqe ndertimi (e marre me qera)	m ²	270
2.	Numri i kateve	mbi toke	1
3.	Kapaciteti perpunues ditor	ton/dite	1.9

Qellimi i projektit.

Projekti ka per qellim vleresimin e ndikimit ne mjedis, ne procesin e shfrytezimit te objektit me aktivitet Perpunimi i ullirit per nxjerjen e vajit.

Ne kete vleresim mjedisor, japim informacion per aktivitetin qe kryhet dhe ndikimet negative dhe pozitive ne mjedis, si dhe masat qe do te merren nga administrata per mbrojtjen dhe menaxhimin e qendrueshem te mjedisit ne territorin e objektit dhe rreth tij.

Projekti krahas interesave ekonomike te investitorit per rritjen e te ardhurave, ka per qellim furnizimin e tregut me produkt te sigurt dhe te certifikuar. Per rikonstrukcionin e objektit jane perdorur materiale cilesore dhe paisje te teknologjise se perparuar.

Me kete vleresim mjedisor japim informacion per kete aktivitet prodhues, vleresimin e ndikimeve negative dhe pozitive ne mjedise, si dhe masat qe do te merren nga investitori per mbrojtjen dhe menaxhimin e qendrueshem te mjedisit ne territorin e kompleksit dhe rreth tij.

Ky raport ka per qellim te jape konsideratat mjedisore te projektit te propozuar ne menyre qe te orientoje institucionet dhe organet vendim marrese ne dhenjen e miratimin e lejes mjedisore te kryerjes se aktivitetit.

Me kete raport sigurojme organet vendim marrese se objekti dhe projekti i zbatuar plotesojne kerkesat e mbrojtjes se mjedisit.